



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:248375
Datë: 18.04.2024
Numri i dokumentit: 05589413

C-IV.-14-5302

Sh A Shtime.

Ankuesi:

Kundër:

N.SH. “Shtime”, KB

përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, lagja Lakrishtë rruga “Dritan Hoxha” nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Ganimete Puka, me datë 18 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr. PRN020-0016 i datës 12 qershor 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Secila palë i bart shpenzimet e veta .

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 11 korrik 2014, ankuesi parashtronj kërkesë- ankesë për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr. PRN020-0016 të datës 12 qershor 2014, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensim për tre paga të papaguara në shumën prej 450.00 € nga N.SH “Shtime”, (në likuidim). Ankuesi pohoi se, vendimi kundër të cilit ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim është i gabuar nga se NSH në fjalë nuk i ka kryer obligimet ndaj neve si punëtor që nga data 22.07.2009 deri më 21.10.2009, për të cilën AKP – Zyra Regjionale, Prishtinë nuk ka dhënë asnjë sugjerim, asnjë formë të pagesës dhe asnjë sqarim për punët dhe obligimet e punëtorëve pas procesit të

privatizimit si dhe gjatë procesit të privatizimit. Ankuesi i propozon Gjykatës, që ankesën e tij ta aprovoj si të bazuar.

Ankuesi ka bashkangjitur si provë: kopjen e vendimit të kundërshtuar.

Me 08 mars 2024, e paditura AKP-ja parashtrori mbrojtje, në të cilën pohoi se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkëlur nga AL në marrjen e vendimit. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e parashkruar në pajtim me nenin 36.2 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034. Më tej e paditura pohoi se një kërkesë monetare e çfarëdo lloji që një punëtor mund të ketë ndaj një punëdhënësi duhet të jetë paraqitur para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent brenda periudhës tre vjeçare nga momenti kur N.SH-ja supozohet të mos i ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj parashtruesit. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së.

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe parashtrësive të palëve.

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)”*, ndërsa pika 3 parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë”*.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtorë i NSH-së, por kontestues ka qenë fakti nëse NSH i ka mbetur borxh pagat e pa paguara në shumën e kërkuar nga ankuesi.

Gjykata nga shkresat e lëndës vjen në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH “Shtime”, nuk i ka bërë pagesën në të cilën kërkon kompensim për tri paga të papaguara në shumën prej 450.00 € për kohë të pacaktuar. Ankuesi, ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij. Kopja e vendimit të atakuar të Autoritetit të Likuidimit, nuk dëshmon se N.SH nuk i ka paguar ankuesit kompensimin e kërkuara në afat të kërkuar.

Në këtë rast ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh kompensimin e kërkuara, po ashtu ankuesi nuk ka dorëzuar ndonjë specifikacion dëshmi lidhur me llogaritjen e kompensimit për tri pagat e kërkuara, por vetëm ka cekur shumën prej 450.00 €. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova në mbështetje të ankesës së tij. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.5 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), secila palë i bart shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme, brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r e

Ganimete Puka